



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 82

Tiranë – E martë, 30 maj 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 33/2023, datë 25.5.2023	Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 9313
Dekret i Presidentit nr. 73, datë 29.5.2023	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 9313
Ligj nr. 34/2023, datë 25.5.2023	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar..... 9314
Dekret i Presidentit nr. 74, datë 29.5.2023	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 9315
Ligj nr. 35/2023, datë 25.5.2023.	Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi..... 9316
Dekret i Presidentit nr. 75, datë 29.5.2023	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 9320
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 25.4.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 5596, datë 21.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1842, datë 9.9.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1625, datë 14.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 9320
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 158, datë 5.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 mw, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë..... 9328

Vendim i Entit Rregullator të
Energjisë nr. 159, datë 5.5.2023

Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Nova Solar system” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw, në zonën kadastrale 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.....

9329

Vendim i Entit Rregullator
të Energjisë nr. 161, datë 9.5.2023

Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërive “Teodori 2003” sh.p.k., “Teodori” sh.p.k. dhe shoqërisë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC-in “Zall i Bulqizës”, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” shpk.....

9331

**LIGJ**
Nr. 33/2023**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN**
NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E
GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Shkronja “a” e pikës 5 të nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

Neni 2

Dispozitë tranzitore

1. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave jo më herët se data 1.1.2026.

2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill, duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 73, datë 29.5.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, **Bajram Begaj**.

DEKRET
Nr. 73, datë 29.5.2023**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E**
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 33/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 33/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**LIGJ**
Nr. 34/2023**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**
NR. 9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT,
SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E
INSTITUCIONEVE TË PAVARURA
KUSHTETUESE DHE TË
INSTITUCIONEVE TË TJERA TË
PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 1 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Institucione kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” janë: institucioni i Presidentit, Kuvendi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Instituti i Statistikave dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive.”.

Neni 2

Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 3**Dispozita të fundit**

1. Në nenin 13, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, fjalët “257 000 lekë në muaj” zëvendësohen me fjalët “425 000 lekë në muaj”.

Neni 4**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 2023 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 74, datë 29.5.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Lidhja nr. 1

RAPORTET E PAGAVE**A**

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Kryetari i Kuvendit	0,925
2	Kryeministri	0,925

B

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Zëvendëskryetari i Kuvendit	0,775
2	Zëvendëskryeministri	0,775



C

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Ministri	0,750

D

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Deputeti	0,730

E

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	0,700

F

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	0,600
2	Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës	0,600
3	Kryetari i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	0,600
4	Kryetari i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	0,600
5	Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive	0,600
6	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	0,600
7	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	0,600
8	Kryetari i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	0,600
9	Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave	0,600

G

Nr.	Funksioni	Raporti
1	Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës	0,450
2	Anëtarët e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	0,450
3	Anëtari i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	0,450
4	Zëvendëskryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive	0,450
5	Anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	0,450

DEKRET

Nr. 74, datë 29.5.2023

Neni 2

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 34/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, ‘Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj’, të ndryshuar”.

Dhënen e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 34/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, ‘Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



LIGJ
Nr. 35/2023

**PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E
PAGAVE, TRAJTIMEVE TË TJERA
FINANCIARE DHE PËRFITIMEVE TË
TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET
E ADMINISTRATËS PUBLIKE, SI DHE
TË PAGËS BAZË MINIMALE
NË SHKALLË VENDI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim krijimin e kuadrit rregullator për kompetencat për caktimin e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe të përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe për përcaktimin e pagës bazë minimale në shkallë vendi.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton institucionet dhe organet që kanë të drejtë të propozojnë dhe të miratojnë:

a) paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit e institucioneve të administratës publike;

b) pagën bazë minimale në shkallë vendi, të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo punëdhënës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Institucione të administratës publike” janë institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e fondeve speciale dhe ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror.

2. “Institucione të administratës shtetërore” janë Kryeministria, ministratë, institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, Forcat e Armatosura, përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe administrata e prefektit.

3. “Institucion i pavarur” ka të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

4. “Njësi e vetëqeverisjes vendore” ka të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

5. “Njësi e fondeve speciale” ka të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. “Trajtime të tjera financiare” janë shpërblimi për rezultate në punë apo inovacion sipas sektorëve, mbështetja financiare e menjëhershme, shtesa e veçantë e kushtëzuar e pagës mbi pagën bruto mujore, çmimet apo shpërblimet për ide inovative dhe inovacion, çmimet apo shpërblimet për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni apo vendi.

7. “Përfitime” janë shërbimet e veçanta, trajtimet e veçanta për nëpunësin, punonjësin dhe/ose fëmijën/familjen e tij, trajnimet, aftësimi, riaftësimi dhe edukimi gjatë gjithë jetës.

8. “Sektor publik” përfshin institucionet e administratës publike dhe entet publike që janë krijuar si të tilla në legjislacionin e krijimit të tyre.

Neni 4
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për funksionarët e zgjedhur apo të emëruar, të përcaktuar në këtë ligj, nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, në vijim të punësuarit në institucionet e administratës publike.

2. Në këtë ligj kompetenca për përcaktimin e pagës bazë minimale në shkallë vendi shtrihet në sektorin publik dhe privat.

3. Në këtë ligj parimet për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe



përfitimeve janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha entet publike.

Neni 5

Parimet për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve

Në përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në sektorin publik, institucionet dhe organet duhet të garantojnë shpërblimin e drejtë dhe dinjitoz të tyre, duke siguruar që institucionet/entet publike:

a) të jenë në gjendje të marrin në punë persona të motivuar dhe që përmbushin me shpejtësi dhe cilësi funksionet e tyre;

b) të motivojnë të punësuarit nëpërmjet skemave të posaçme që të rrisin performancën në punë;

c) të sigurojnë një shpërblim të drejtë dhe të barabartë për punë të njëjta;

ç) të krijohet një sistem pagash, trajtimesh të tjera financiare dhe përfitimesh, që mund t'i përgjigjet nevojës për të përmbushur prioritetet;

d) të jenë në gjendje të konkurrojnë me sektorin privat për punësimin e punonjësve të talentuar.

KREU II

KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE, TË TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE PËRFITIMEVE

Neni 6

Organet kompetente

Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, sipas përkatësisë:

a) Kuvendi;

b) Këshilli i Ministrave;

c) këshillat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore;

ç) organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale;

d) organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;

dh) organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera, të ndryshme nga ato të buxhetit të

shtetit, dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit, organizimit dhe funksionimit të tyre.

Neni 7

Kompetencat e Kuvendit

Kuvendi miraton me ligj:

a) pagën bruto mujore të Presidentit, në kuadër të miratimit të ligjit vjetor të buxhetit;

b) raportet e pagave për Kryeministrin, deputetët, ministrat dhe titullarët e anëtarët e organeve kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj;

c) elementet përbërëse të pagës bruto mujore për të punësuarit, me përjashtim të të punësuarve në njësitë e fondeve speciale dhe në ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;

ç) vlerën e çdo elementi të pagës bruto mujore për titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese, në kuadër të miratimit të ligjit të krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përkatës.

Neni 8

Kompetencat e Këshillit të Ministrave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit, miraton pagën bazë minimale mujore në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo punëdhënës në Republikën e Shqipërisë. Gjatë procesit të përgatitjes së projektvendimit ministri përgjegjës për çështjet e punësimit e bashkërendon atë me Departamentin e Administratës Publike dhe ministrinë përgjegjëse për financat.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e zëvendëskryeministrit ose të ministrit nën përgjegjësinë e të cilit është Departamenti i Administratës Publike, në rastin kur DAP-i është nën përgjegjësinë e një ministri, miraton:

a) elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore për të punësuarit në institucionet e administratës publik, për të cilët këto elemente nuk janë shprehur në ligjet e posaçme/të tjera, me përjashtim të të punësuarve për të cilët kjo kompetencë i është dhënë një institucioni/organi tjetër sipas përcaktimit në këtë ligj;



b) masën e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit, si dhe rregullat për zbatimin e tij. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë;

c) rregullat, kriteret dhe masën për trajtime të tjera financiare dhe përfitime, si dhe rregullat për pagesën shtesë për punën e kryer mbi kohën normale të punës në ditët e festave zyrtare e të pushimit javor dhe për raste të tjera të parashikuara në Kodin e Punës dhe në ligje të tjera të veçanta, me përjashtim të të punësuarve për të cilët kjo kompetencë i është dhënë një institucioni/organi tjetër sipas përcaktimit në këtë ligj apo në ligje të tjera;

ç) klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe kufijtë maksimalë e minimalë të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar dhe të punësuarit e tjerë në njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) shtesën e veçantë të kushtëzuar mbi pagën bruto mujore, sipas fushave dhe/ose nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit, që nuk tejkalon vlerën e pagës mesatare mujore të sektorit respektiv në vendet e Bashkimit Europian, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë pagën mesatare mujore më të lartë të një prej vendeve të Bashkimit Europian, referuar të dhënave të Eurostatit;

dh) listën e fushave dhe/ose nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit, si dhe pozicionet apo funksionet që përfitojnë shtesën e veçantë të kushtëzuar, të përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij neni;

e) kriteret, procedurat dhe institucionet kompetente për lidhjen e marrëveshjeve me entitete të treta, që u mundësojnë punonjësve të administratës publike shërbime dhe tarifa preferenciale.

3. Gjatë procesit të hartimit të projektvendimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Departamenti i Administratës Publike i bashkërendon ato me ministrin përgjegjës për financat për sa u përket efekteve të tyre financiare.

4. Projektvendimet e Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, vlerësohen dhe përgatiten nga Departamenti i Administratës Publike:

a) kryesisht në rastin e rritjeve apo reformës së përgjithshme të pagave, bazuar në disponueshmërinë e fondeve përkatëse të vëna në dispozicion nga ana e ministrit përgjegjës për financat;

b) pas kërkesës së Kryeministrit;

c) pas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në rastin e ndryshimeve për Kryeministrinë apo ndryshimeve dhe krijimit të institucioneve në varësi të Kryeministrit;

ç) pas kërkesës së ministrave të linjës në rastin e ministrave të linjës apo ndryshimeve dhe krijimit të institucioneve në varësi të ministrave të linjës;

d) pas kërkesës së titullarëve të institucioneve të pavarura, organeve drejtuese të njësive të vetëqeverisjes vendore apo Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

5. Këshilli i Ministrave, sipas rastit, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton:

a) shpërblimin e anëtarëve të këshillave, të bordeve ose të çdo organi tjetër kolegjial të institucioneve të administratës shtetërore, kur legjislacioni përkatës parashikon krijimin e një këshilli/bordi drejtues apo organi kolegjial me të drejtë pagese në këto institucione, me përjashtim të atyre të shoqërive aksionare/tregtare apo të institucioneve të tjera, rregullimi i të cilave bëhet me ligje të veçanta;

b) masën e mbështetjes financiare të menjëhershme në rastet e situatave të vështira ekonomiko-shoqërore apo situatave të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për të punësuarit në institucionet e administratës publike, me përjashtim të të punësuarve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë, miraton kufirin maksimal të pagës dhe të shpërblimit të titullarit të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror, si dhe kufirin e shpërblimit të anëtarëve të këshillave ose të bordeve drejtuese të tyre.

7. Gjatë procesit të përgatitjes së projektvendimeve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, ato bashkërendohen me Departamentin e Administratës Publike.



Neni 9

Kompetencat e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore

Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë:

a) vlerën e pagës për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar dhe për çdo të punësuar tjetër brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësive të vetëqeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

b) njësimin në pagë në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për çdo funksion të ri që vendosin të krijojnë;

c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

ç) shpërblime të personave nga burimet e veta financiare, të cilat caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;

d) pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve, kur me ligj të veçantë, është parashikuar ndryshe;

dh) masën e mbështetjes financiare të menjëhershme në rastet e situatave të vështira ekonomiko-shoqërore ose situatave të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për të punësuarit e tyre.

Neni 10

Kompetencat e organeve kolegjiale

1. Organet kolegjiale drejtuese, të përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “d” të nenit 6 të këtij ligji, miratojnë:

a) elementet përbërëse të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;

b) vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre, duke respektuar kufirin maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri nën përgjegjësinë e të cilit janë;

c) masën e shpërblimit për rezultate në punë, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas

daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri përkatës nën përgjegjësinë e të cilit janë.

2. Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të ministrit përgjegjës për financat, miraton me akte të veçanta nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të të punësuarve të tyre.

3. Organet kolegjiale drejtuese, të përcaktuara në shkronjën “dh” të nenit 6 të këtij ligji, kur nuk ka përcaktime në ligjin e tyre specifik, miratojnë:

a) elementet përbërëse të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;

b) vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;

c) rregullat, kriteret dhe masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Shfuqizime

Ligji nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, shfuqizohet.

Neni 12

Dispozitë kalimtare

1. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të cilat përcaktojnë paga dhe shpërblime për institucione të administratës publike dhe ente publike, që nuk janë në fushën e veprimit të këtij ligji, mbeten në fuqi dhe do të vazhdojnë të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore nga autoritetet përgjegjëse në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.



Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 75, datë 29.5.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 75, datë 29.5.2023

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM
Nr. 23, datë 25.4.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;

me sekretare Belma Lleshi, në datën 25.4.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen me nr. 9 (K) 2022, që u përket:

KËRKUES: Kujtim Doku

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore,

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5596, datë 21.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1842, datë 9.9.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1625, datë 14.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kujtim Doku ka shërbyer si oficer aktiv në strukturat e Forcave të Armatosura nga data 1.1.1971 deri në datën 1.10.1993. Me urdhrin nr. 2574, datë 18.10.1993 të ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi, në detyrën komandant regjimenti k/tank pranë Repartit Ushtarak nr. 2112 Fushë-Krujë, është nxjerrë në rezervë me gradën “N/Kolonel” dhe është trajtuar me pagesë kalimtare për periudhën nga 18.10.1993 deri 18.10.1995, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 7496, datë 3.7.1991, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 7496/1991*) dhe VKM-në nr. 225, datë 29.5.1992, “Për trajtimin financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”. Atij i janë njohur vjetërsi shërbimi si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm 22 vjet e 9 muaj dhe pagë referuese e llogaritur për funksionin organik që ka pasur në momentin e shkëputjes së marrëdhënies së punës në masën 18.306 lekë. Nga data 18.10.1995 deri në datën 31.12.1998 pagesa kalimtare i është ndërprerë.

2. Prej datës 1.1.1999 kërkuesi është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në bazë të vendimit për caktim pensioni nr. 173, datë 5.6.2000, sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit” (*ligji nr. 8087/1996*), i ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999. Masa e pensionit të parakohshëm në këtë datë rezulton të jetë caktuar dhe paguar në shumën 8.000 lekë.

3. Në datën 14.5.2004 ka hyrë në fuqi ligji nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9210/2004*), i cili në nenin 35 parashikonte të drejtën për pension të parakohshëm për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët me pagesë/profesionistë me vjetërsi shërbimi 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Në vijim është miratuar ligji nr. 9418, datë 20.5.2005,

“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9418/2005*), i cili është ndryshuar me ligjin nr. 9481, datë 16.2.2006. Ky i fundit është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 9, datë 26.2.2007, ka vendosur shfuqizimin e neneve 1, 7, shkronjat “a” dhe “b” e 9 të tij.

4. Në zbatim të vendimit të Gjykatës është miratuar ligji nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të RSH-së” (*ligji nr. 10142/2009*), i cili parashikonte se pensioni i parakohshëm për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 50 për qind e pagës mesatare referuese mujore. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, sipas përcaktimit, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës mesatare referuese. Masa e pensionit të parakohshëm, e llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, në çastin që lind e drejta për përfitim: a) për personat që nuk kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*); b) për personat që kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703/1993, shtuar me 2 për qind të pagës mesatare referuese, për çdo vit sigurimi suplementar. Në këtë rast, shumën e pensionit mujor të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë të pleqërisë, plus 20 për qind të pagës referuese të muajit të fundit të punës (*neni 14, pikat 1 dhe 2*).

5. Gjithashtu, ky ligj parashikonte se dispozitat e ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit” (*ligji nr. 8661/2000*) zbatohen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare, të caktuara në përputhje me ligjet nr. 8087/1996 dhe nr. 8661/2000, si dhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, pavarësisht nga mosha e vjetërsia në punë, në çastin e fillimit të së drejtës, do të rillogariten. Rillogaritja bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagave referuese, në çastin që i ka lindur e drejta për përfitim. Mbi këtë masë përfitimi të rivlerësuar



zbatohen koeficientet e rritjes ose të indeksimit të pensionit, sipas vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, nga çasti i lindjes së të drejtës deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Masa e pensionit, e rivlerësuar si më lart, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ose e pensionit suplementar (*neni 29, pika 1*).

6. Ligji nr. 10142/2009 është kundërshtuar në Gjykatë, e cila, me vendimin nr. 33, datë 24.6.2010, ka vendosur shfuqizimin e pikës 2 të nenit 14, si dhe të nenit 27 të këtij ligji. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë aktin normativ nr. 5, datë 10.11.2010, i cili është miratuar me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 10.11.2010, të Këshillit të Ministrave, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10142/2009’”. Sipas këtij akti normativ, pikat 1 dhe 2 të nenit 14 janë ndryshuar duke parashikuar se pensioni i parakohshëm, për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto, për çdo vit shërbimi (*pika 1*). Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703/1993 (*pika 2*). Akti normativ dhe ligji miratues përkatës i janë nënshtruar sërish kontrollit kushtetues nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 2, datë 18.2.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

7. Për sa i përket kërkesit, bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009, DRSSH-ja, Tiranë ka rillogaritur masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke i njohur atij si masë përfundimtare nga data 1.7.2009 pensionin e parakohshëm në shumën 10.576 lekë.

8. Kërkesi ka pretenduar se llogaritja e pensionit ishte bërë në mënyrë të gabuar, arsyë për të cilën i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të vendosë dhe paguajë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996, duke e rritur dhe indeksuar atë nga data 1.1.1999 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të paguajë diferencat e krijuara midis masës së pensionit sipas ligjit nr. 8087/1996 dhe pensionit të paguar nga data 1.1.1999 e në vijim deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të paguajë

kamatëvonesat për shumën e diferencave që rezultojnë nga data 1.1.1999 e në vijim; detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për të shpërblyer humbjen pasurore nga ulja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke kthyer (paguar) begatimin pa shkak të ligjshëm të kërkesit në vlerën e masës së diferencës së vlerës midis pensionit sipas ligjit dhe pensionit të paguar nga data 1.1.1999 deri në marrjen e vendimit.

9. Me vendimin nr. 5596, datë 21.5.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë të paguajë paditësit Kujtim Doku diferencat e paguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi prej datës 1.1.1999 deri në datën 30.6.2009 në masën 818.370 (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër si të pabazuar në prova dhe në ligj.*”. Kjo gjykatë ka arsyetuar se bazuar edhe në aktin e ekspertit kontabël, kërkesi duhet të trajtohej me pension të parakohshëm në masën 13,169 lekë dhe jo 8,000 lekë për periudhën nga 1.1.1999 deri 30.6.2009. Me ligjin nr. 10142/2009, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.7.2009, pensioni do të llogaritej sipas dispozitave të këtij ligji, të cilat ndryshojnë nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim palët ndërgjyqëse.

10. Me vendimin nr. 1632, datë 23.4.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit Tiranë. Dërgimin e akteve për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit.*”.

11. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1842, datë 9.9.2015, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 5596 datë 21.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e pjesës të padisë. Detyrimin e të paditurit DRSSH-së, Tiranë t'i paguajë paditësit Kujtim Doku shumën prej 597.477 (pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, si diferenca të paguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 1.1.1999–30.6.2009. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër.*”. Gjykata e apelit ka arsyetuar se në bazë të shpjegimeve të ekspertit kontabël, përfshirë aplikimin e rritjeve të përvitshme të pazbatuar mbi diferencën nga momenti i caktimit të pleqërisë, shuma e pensionit është në masën 12,082 lekë në muaj. Ndërsa në lidhje me pretendimin e kërkesit për moszbatimin e ligjit nr. 10142/2009, kjo gjykatë



ka arsyetuar në të njëjtën linjë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs palët ndërgjyqëse.

12. Me vendimin nr. 00-2022-1625, datë 14.7.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe pala paditëse Kujtim Doku, kundër vendimit nr. 1842, datë 9.9.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit”*. Ky kolegji, pa i hyrë analizës ligjore të shkaqeve të rekursit të paraqitur nga palët, ka vlerësuar se ndodhej para kushteve ligjore që përcaktojnë kufirin monetar, të parashikuar nga neni 56, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, të ndryshuar, sipas të cilit nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Në kohën e ushtrimit të rekursit, dyzetfishi i pagës minimale ishte në vlerë më të lartë se vlera e objektit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë.

13. Në datën 11.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 17.1.2023 ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt, në drejtim të:

14.1. *Parimit të hierarkisë së akteve normative*, pasi akti normativ nr. 5, datë 10.11.2010, i cili është miratuar me shumicë të thjeshtë dhe procedurë të përsheptuar me ligjin nr. 10367/2010, ka zvogëluar masën e pensionit të parakohshëm të përcaktuar me ligjin nr. 9210/2004, një ligj i miratuar me shumicë të cilësuar. Pavarësisht këtij fakti, Gjykata

e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë pranuar kërkesën e kërkuetit për t'u trajtuar me masën e pensionit sipas ligjit nr. 9210/2004, por kanë zvogëluar masën e pensionit nga 25.564 lekë në 10.537 lekë.

14.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara*, pasi e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është një e drejtë që kërkueti e ka fituar me ligjin nr. 7496/1991, e konfirmuar me ligjin nr. 9210/2004, që nga data e lindjes së kësaj të drejte deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ligji nr. 10142/2009 nuk mund të cenonte dhe ndryshonte masën e përfitimit dhe llogaritjen e pensionit duke e zvogëluar atë. Për rrjedhojë, është cenuar edhe parimi i pritshmërive të ligjshme. Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, të cilat e kufizojnë këtë të drejtë deri në datën 30.6.2009 dhe pranojnë rilogaritjen e pensionit me uljen e tij, kanë cenuar këtë parim. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë objekt kundërshtimi cenon të drejtën për përfitimin e plotë të së drejtës së pensionit të parakohshëm në përputhje me ligjet nr. 7496/1991, nr. 8087/1996, nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005 deri në datën 13.2.2016 kur kërkuesi ka plotësuar kushtet për pension pleqërie. Pavarësisht se masa e pensionit të përfituar i garantohej “deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie”, të dyja gjykatat më të ulëta e kanë pranuar këtë masë deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142/2009. Vendimet objekt kundërshtimi janë në kundërshtim me vendimet e Gjykatës nr. 9/2007, nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013.

14.3. *Së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë dhe së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të zbatonte vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate nr. 3, datë 6.12.2013, sipas të cilit kufizimi i së drejtës së ankimit nuk mund të shtrihet ndaj ankimeve të ushtruara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, Kolegji Administrativ në vendimin objekt kundërshtimi i është referuar kufizimit të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 për moslejimin e ushtrimit të së drejtës së rekursit për mosmarrëveshjet që janë me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale. Nëse gjykatat e shkallës së parë dhe apelit do të vlerësonin shumën që DRSSH-ja, Tiranë i detyrohej kërkuetit edhe për periudhën nga 30.6.2009 deri 13.2.2016 (kohë kur



ai ka plotësuar kushtet e daljes në pension), ajo do të ishte në vlerën 1,466,666 lekë, pra më e lartë se kufiri ligjor i përcaktuar në ligj.

14.4. *Parimit të ndalimit të fuqisë prapavepruese*, vendimi nr. 33/2010 i Gjykatës njeh fuqinë prapavepruese të rilogaritjes vetëm në rast se ajo rrit masën e përfitimit të pensionit të parakohshëm. Rilogaritja e parashikuar nga ligji nr. 10142/2009 nuk mund të bëhet jashtë kontekstit të vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës, por vetëm nëse ndryshon pozitivisht situatën e përfituesve. Edhe vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës është në linjë me vendimin nr. 33/2010 të saj.

14.5. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi padia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 30.7.2010, kur nuk kishte hyrë në fuqi ende ligji nr. 49/2012 dhe kompetente për të gjykuar çështjen e tij nuk duhet të ishte gjykata administrative.

14.6. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi kërkesëpadia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 30.7.2010, ndërsa vendimi i shqyrtimit të çështjes është i datës 21.5.2013, pra pas 2 vjetësh, 8 muajsh dhe 22 ditësh. Gjykimi në gjykatën e apelit ka zgjatur nga data 5.6.2013, kur është paraqitur ankimi, deri në datën 9.9.2015, në tejkalim të afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49/2012. Edhe në Gjykatën e Lartë gjykimi ka zgjatur më tepër se 7 vjet, nga data 5.10.2015 deri në datën 14.7.2022.

15. *Subjektet e interesuara, DRSSH-ja dhe ISSH-ja*, ndonëse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur përpjesime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi

kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Gjykata vëren se kërkesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin janë marrë vendimet objekt kundërshtimi, si dhe është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

18. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 56, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e saj, në referim të ndryshimeve ligjore të bëra në nenet 399/1 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile (KPC), Gjykata ka vlerësuar se, si rregull, individ duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se këto mjete të reja procedurale kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017, pra ndërkohë që gjykimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ishte ende në proces. Nga materialet e çështjes nuk rezulton që kërkesi t'i ketë shfrytëzuar këto mjete ligjore, por e ka parashtruar pretendimin drejtpërdrejt përpara Gjykatës. Prandaj në lidhje me këtë pretendim ai nuk i ka shteruar mjetet ligjore efektive përpara se të vinte në lëvizje këtë gjykim kushtetues. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera, në kushtet kur nuk



ka mjet tjetër ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se kërkuksi i ka shteruar mjetet e ankimit në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

21. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 14.7.2022, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 11.11.2022. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur ankimin kushtetues brenda afatit 4 – mujor të parashikuar nga dispozita e sipërcituar.

22. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuksin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuksit për cenimin e parimit të hierarkisë së akteve normative, të parimit të sigurisë juridike dhe të të drejtave të fituara, si dhe të parimit të ndalimit të fuqisë prapavepruese në thelb kanë të bëjnë me parimin e sigurisë juridike në drejtim të garantimit të së drejtës për pension të parakohshëm. Prandaj, pavarësisht mënyrës se si janë parashtruar në kërkesë këto pretendime, duke iu referuar përmbajtjes së tyre, Gjykata vlerëson se ato duhen trajtuar në këndvështrim të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit, si dhe parimeve të sigurisë juridike dhe gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit

23. Kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të zbatonte vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate nr. 3/2013, sipas të cilit kufizimi i së drejtës së ankimit nuk mund të shtrihet ndaj

ankimeve të ushtruara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, Kolegji Administrativ në vendimin objekt kundërshtimi i është referuar kufizimit të nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 për moslejimin e ushtrimit të së drejtës së rekursit për mosmarrëveshjet që janë me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale. Gjithashtu, nëse gjykatat e shkallës së parë dhe apelit do të vlerësonin shumën që DRSSH-ja, Tiranë i detyrohej kërkuksit edhe për periudhën nga 30.6.2009 deri 13.2.2016 (kohë kur ai ka plotësuar kushtet e daljes në pension), ajo do të ishte në vlerën 1,466,666 lekë, pra më e lartë se kufiri ligjor i përcaktuar në ligj.

24. Sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përpunje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset vetëm me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës.

25. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).



26. Në jurisprudencën kushtetuese, gjithashtu, është pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv. Gjykata ka pohuar se në rastet kur kërkuar nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimi të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuar, në pikën 7 të

dispozitivit të vendimit të saj ka vendosur se kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se përmbushen kushtet ligjore në lidhje me kufirin monetar të parashikuar nga neni 56, shkronja “ç”, i ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Ajo ka argumentuar se në kohën e ushtrimit të rekursit, dyzetfishi i pagës minimale ishte në vlerë më të lartë se vlera e objektit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafin 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe pse ka qenë Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka orientuar kërkuar të ushtrojë të drejtën e rekursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e shkaqeve të ngritura në rekurs nga kërkuar, por është ndalur në faktin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm. Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata e Lartë është bazuar vetëm te disponimi i gjykatës së apelit në dispozitiv, e cila ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e kërkuar dhe i ka njohur atij shumën 597.477 lekë (*shih paragrafi 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), pavarësisht se neni 61, paragrafi 1, i KPC-së parashikon se vlera e padisë, pra e objektit të mosmarrëveshjes, përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kjo dispozitë procedurale nuk rezulton se është analizuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila, gjithashtu, nuk ka arsyetuar shkaqet e qëndrimit të saj, pra pse vlera e mosmarrëveshjes përcaktohej nga shuma e njohur vetëm pjesërisht nga Gjykata Administrative e Apelit.

31. Për sa i përket objektit të kërkesëpadisë së kërkuar, Gjykata vëren se megjithëse nuk është përcaktuar vlera konkrete e mosmarrëveshjes, gjithsesi ajo është e përcaktueshme, pasi kërkuar ka pretenduar përlllogaritjen e pensionit të parakohshëm të pleqërisë sipas ligjeve nr. 7496/1991 dhe nr. 9210/2004 deri në



përmbushjen e kushteve për pension pleqërie (data 13.2.2006), e cila, sipas kërkesit, arrin në masën 1.468.666 lekë. Kjo shumë është më e lartë se 880.000 lekë që përbën dyzetfishin e pagës minimale në vend në kohën e paraqitjes së rekursit.

32. Gjykata në jurisprudencë të vazhdueshme ka pohuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Bazuar në standardet e mësipërme dhe duke pasur në konsideratë rrethanat dhe faktet e rastit konkret, Gjykata vlerëson se kufizimi i parashikuar nga neni 56, shkronja “ç”, i ligjit nr. 49/2012 nuk është zbatuar nga Gjykata e Lartë në nivel të mjaftueshëm qartësie. Mënyra e zbatimit të ligjit nga ajo gjykatë në dukje është e paarsyetuar dhe ka vendosur ndaj kërkesit një barrë joproporcionale, e cila nuk respekton në këtë mënyrë balancën e drejtë dhe të nevojshme midis qëllimit legjitim për të garantuar respektimin e kushteve formale për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, nga njëra anë, dhe së drejtës për t’iu drejtuar asaj gjykate, nga ana tjetër.

34. Nën dritën e analizës së mësipërme, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte se përse në llogaritjen e vlerës së mosmarrëveshjes, që përcakton ankueshmërinë ose jo të vendimit të apelit, i është referuar dispozitivit të vendimit të apelit dhe jo vlerës së mosmarrëveshjes që rezulton nga kërkesëpadia. Një arsyetim i tillë, jo vetëm do t’i bënte të kuptueshme arsyet e qëndrimit të Gjykatës së Lartë, por edhe do ta përligjte vendimmarrjen e saj. Prandaj, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duke mos arsyetuar qëndrimin e tij, si dhe duke mos i dhënë për këtë arsye përgjigje përfundimtare shkaqeve të paraqitura në rekurs, nuk plotëson kërkesat për proces të rregullt ligjor, si dhe krijon paqartësi, duke i cenuar kërkesit edhe të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë dhe të drejtën e aksesit. Për pasojë, pretendimi i kërkesit në këtë drejtim është i bazuar dhe vendimi i

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet.

35. Bazuar në sa më sipër, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të subsidiaritetit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkesit, që kanë të bëjnë me parimin e sigurisë juridike dhe gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga ajo gjykatë.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa, sipas arsytimit të mësipërm, është pjesërisht e bazuar dhe duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1625, datë 14.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.4.2023.

Shpallur më 25.5.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahim



VENDIM

Nr. 158, datë 5.5.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU
GREEN ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU
EOLIK I ERËS “DROPULLI WIND”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw, NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE
JORGUCAT, BASHKIA DROPULL,
QARKU GJIROKASTËR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1069/3 prot., datë 3.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘EU Green Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës ‘Dropulli Wind’, me kapacitet të instaluar 20 mw, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë”, konstatoi se:

- Shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1069, datë 15.3.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike të erës “Dropulli Wind”, për fazën e parë dhe të dytë të zhvillimit “Dropulli Wind-1” dhe “Dropulli Wind-2”.

- Miratimi paraprak nr. 469/5, datë 7.12.2021, i lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 20 mw, i cili nuk përfiton nga masat

mbështetëse dhe veprave ndihmëse në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë”, i është dhënë bashkimit të përkohshëm të shoqërive “EU Green Energy” sh.p.k., “Winpharma” sh.p.k. dhe “A.91” sh.p.k., për projektin e ndërtimit të centralit eolik me kapacitet të instaluar 20 mw. Në këto rrethana, ERE do të vlerësojë dokumentacionin e depozituar në kuptim të fuqisë 20 mw, pasi edhe formati i aplikimit me të dhënat teknike sipas shtojcës 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në germën “a”, kur trajtohet kapaciteti i instaluar, shoqëria e ka plotësuar këtë zë me fuqinë 20 mw.

- Duke qenë se në ERE nuk rezulton që të jetë depozituar ndonjë akt ku të tria shoqëritë apo MIE të kenë dhënë miratimin e tyre që licenca t’i jepet shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k., e cila është shoqëria që ka paraqitur aplikimin në ERE dhe po ashtu shoqëria, së cilës i është dhënë VNM-ja paraprake dhe miratimi në parim i pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit, do të sqarohet me aplikuesin apo edhe me MIE-n, në lidhje me përcaktimin e shoqërisë që do të marrë licencën që do të operojë centralin eolik “Dropulli Wind”.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k. rezulton se ai është plotësuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.1, gerrat: “a”, “d” dhe “e”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Pika 2, dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germën “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE autorizimin përkatës për miratimin e ndërtimit të këtij projekti dhe/ose kontratën e nënshkruar me MIE-n;

- germën “c”: Shoqëria, në vijim të miratimit paraprak të pikës së lidhjes me rrjetin e



transmetimit nga OST sh.a., duhet të depozitojë miratimin përfundimtar për pikën e lidhjes me rrjetin.

- Për sa parashikuar në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi fillimin apo fazën në të cilën ndodhen punimet për ndërtimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 mw, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, qarku Gjirokastrë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “EU Green Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 159, datë 5.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw, NË ZONËN KADASTRALE 3358, FSHATI SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/1 prot., datë 3.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, në zonën kadastrale 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319 prot., datë 26.04.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,



miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Apikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerën “c” dhe për pikën 2, gjerat “d” dhe “e”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9, formati dhe dokumentacioni për aplikim

pika 1, dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- pika 1.1

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE formatin e aplikimit sipas shtojcës 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj;

- pika 1.2, dokumentacioni juridik dhe administrativ

- gjerat “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë dhe administratorin tjetër të saj;

- gjerat “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të saj, duke reflektuar saktësimet/ndryshimet përkatëse referuar të dhënave që rezultojnë nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- Pika 1.3, dokumentacioni financiar dhe fiskal

- gjerat “a”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin përkatës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- gjerat “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentet vërtetuese të mbulimit të 20 % të vlerës së investimit.

Pika 2, dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- 2.1 Shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të plotësuar:

- gjerat “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën me MIE-n, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- gjerat “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

- Gjithashtu, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 161, datë 9.5.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRIVE “TEODORI 2003” SHPK,
“TEODORI” SHPK DHE SHOQËRISË
“KONCESIONARE TËRNOVË ZALL
BULQIZË” SHPK, PËR TRANSFERIMIN
E PJESSHËM TË LICENCËS PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR HEC-in “ZALL I
BULQIZË”, NGA SHOQËRIA
“TEODORI 2003” SHPK TE SHOQËRIA
“KONCESIONARE TËRNOVË ZALL
BULQIZË” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 43 dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 1 dhe 3 dhe neneve 15 dhe 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1202/8 prot., datë 8.5.2023, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërive “Teodori 2003” sh.p.k., “Teodori” sh.p.k. dhe shoqërisë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Teodori” sh.p.k. dhe shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1202 prot., datë 6.4.2023, i janë drejtuar ERE-s dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me kërkesën për transferimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

- Në vijim në ERE është paraqitur kërkesa e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., nënshkruar nga një prej administratorëve të saj, Z. L. L., protokolluar me nr. 1202/2 prot., datë 14.4.2023, për rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori” sh.p.k. sipas objektit të sipërcituar.

- Me shkresën nr. 1202/3 prot., datë 18.4.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë “Teodori” sh.p.k. dhe shoqërinë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. duke i bërë me dije se përpara se ERE të shprehet në lidhje me kërkesën e tyre, do të shqyrtojë dhe kërkesën dhe dokumentacionin e depozituar nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., duke i kërkuar gjithashtu qëndrimin përkatës të MIE-s, në rast se ka një tillë, duke qenë se e njëjta kërkesë i është dërguar dhe MIE-s. Po ashtu, në të njëjtën shkresë, ERE ka kërkuar saktësimin e kësaj kërkesë, duke specifikuar nëse i referohet transferimit të plotë të licencës nr. 87, seria PV09K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Tërnovë”, apo transferimit të pjesshëm të saj, duke transferuar në këtë mënyrë vetëm të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Zalli i Bulqizës”.

- Në vijim, në ERE është paraqitur dhe kërkesa e shoqërisë “Albania Hydro Investment Holding” sh.p.k., protokolluar me nr. 1202/4 prot., datë 18.4.2023, për rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për transferimin e licencës së prodhimit. Kjo shoqëri rezulton ortak me 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1202/5 prot., datë 27.4.2023, shoqëritë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqëria “Teodori” sh.p.k. dhe shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., kanë paraqitur në ERE “Kërkesë për transferimin e pjesshëm të licencës nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., me NIPT M219010311, për HEC-in Zall i Bulqizës sipas Marrëveshjes së Koncesionit, datë 6.5.2003, miratuar me VKM nr. 556, datë 1.8.2003”.

- Shkresa e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., është nënshkruar nga një prej administratorëve të saj, Z. F. T.

- Po ashtu, me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 1202/6 prot., datë 5.5.2023 dhe nr. 1202/7



prot., datë 5.5.2023, shoqëria “Teodori” sh.p.k. dhe shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., kanë depozituar në ERE dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Në zbatim të nenit 17 pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, i licencuar nga ERE është në këtë rast shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., që është mbajtës i licencës nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” me kapacitet të instaluar 5.350 mw dhe HEC “i Tërnovës” me kapacitet të instaluar 8.385 mw.

- Duke qenë se në ERE është depozituar një vendim i organeve drejtuese të shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., në të cilin shprehet vullneti i të gjithë Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie për të transferuar të drejtën e ndërtimit dhe operimit të HEC-it “Zalli i Bulqizës”, duke ia kaluar këtë të drejtë një shoqërie tjetër, sipas përcaktimit që do të bëjë shoqëria “Teodori” sh.p.k. ashtu sikurse është depozituar dhe dokumentacion/informacion për sa kërkohet nga rregullorja, vlerësohet fillimi i procedurës për transferimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, sipas kërkesës, duke transferuar te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. të drejtën e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Zalli i Bulqizës”.

- Shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., ka kryer për llogari të ERE-s pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores. Po ashtu, nuk rezulton që i licencuari, “Teodori 2003” sh.p.k. të jetë debitor për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, rezulton se ai është plotësuar si vijon:

Neni 17, pika 2, gerrat “b”, “c”, “d” dhe “e”. Plotësuar.

- Rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni si vijon:

- **germa “a”:** Shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., duhet të depozitojë të plotësuar në të gjitha zërat e saj shtojcën 1.

- **germa “f”:** në vendimin e Asamblesë së Ortakëve të datës 20.12.2014, në të cilin është vendosur të ndahet koncesioni i HEC “Zalli i

Bulqizës”, duke ia kaluar këtë të drejtë një shoqërie tjetër, sipas përcaktimit që do të bëjë shoqëria “Teodori” sh.p.k. është përcaktuar se kjo kushtëzohet me miratimin e organit shtetëror të autorizuar, që në këtë rast është MIE.

Po ashtu rezulton se koncesionari ka vënë në dijeni MIE-n dhe shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k. për krijimin e shoqërisë së re koncesionare dhe është kërkuar miratimi dhe mbështetja e MIE-s për pajisjen me lejet e nevojshme, duke përfshirë këtu edhe procedurën për transferimin e licencës në ERE. Duke qenë se nuk është depozituar ende asnjë qëndrim apo akt miratimi i organit shtetëror të autorizuar (MIE-s), në lidhje me njohjen e të drejtës së shoqërisë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. për të ndërtuar dhe operuar HEC-in “Zalli i Bulqizës”, vlerësohet që t’i kërkohet shoqërisë që ta depozitojë në vijim.

- Në nenin 17, pika 3, të rregullores, parashikohet se: në rastin e transferimit të pjesëshëm të aseteve, ERE zbaton të njëjtat procedura si për transferimin e plotë të përshkruar në pikën 2 por para se të vendosë për licencimin e personit tek i cili do të transferohen pjesërisht asetet, do të kryejë modifikimin e licencës të personit të licencuar që ka kryer transferimin e pjesshëm të aseteve.

- Në këtë rast, me fillimin e procedurës për transferimin e pjesshëm të licencës, do të fillojë dhe procedura për modifikimin e licencës nr. 87, seria PV09K, miratuar për shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, për prodhimin e energjisë elektrike, duke transferuar nga kjo licencë HEC “Zalli i Bulqizës” me kapacitet të instaluar 5.350 mw te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

- Në nenin 17, pika 5, të rregullores, parashikohet se: në rastet e transferimit të plotë ose të pjesshëm të licencës, që shoqërohet dhe me transferimin e aseteve fikse të të licencuarit, aplikimi për këtë transferim duhet të bëhet paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit.

- Për sa më sipër parashikuar, duke qenë se HEC-i “Zalli i Bulqizës”, për të cilin kërkohet të transferohet dhe e drejta e operimit, nuk është ndërtuar ende, kjo procedurë nuk shoqërohet me asete fikse të të licencuarit e në këto rrethana nuk mund të bëhet aplikim për transferimin e aseteve.



- Për gjithë sa më sipër parashtruar dhe në kuadër të fillimit të procedurës për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC-in “Zall i Bulqizës”, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., vlerësohet që kërkesat për rrëzimin e kërkesës për transferimin e licencës, konkretisht nga një prej administratorëve të shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., Z. L. L dhe nga një prej ortakëve të shoqërisë “Teodori 2003”, “Albania Hydro Investment Holding” sh.p.k., të vlerësohen në vijim, në kuadër të komenteve apo objeksioneve në lidhje me këtë vendimmarrje, që parashikohen përkatësisht në nenin 10, pika 10 dhe 13 dhe nenin 17, pika 6 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall

Bulqizë” sh.p.k., vetëm për HEC-in “Zalli i Bulqizës”, me kapacitet të instaluar 5.350 mw.

2. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, për shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., vetëm për HEC-in “Zalli i Bulqizës”, me kapacitet të instaluar 5.350 mw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërinë “Teodori” sh.p.k., shoqërinë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. L. L dhe shoqërinë “Albania Hydro Investment Holding” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë